

VENDIM
Nr. 735, datë 8.12.2017

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURISIT
“TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE” TRUALL, TË PASURISË ME NR. 61/6/6,
ZONA KADASTRALE 1503, BASHKIA TROPOJË, TË PASURISË ME NR. 886, ZONA
KADASTRALE 1402, BASHKIA DIBËR, TË PASURISË ME NR. 792, ZONA KADASTRALE
3509, BASHKIA DIBËR, TË PASURIVE ME NR. 36 DHE 66, ZONA KADASTRALE 2640,
BASHKIA DIBËR, TË PASURISË ME NR. 157/13, ZONA KADASTRALE 2302, BASHKIA
SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me nr. 61/6/6, zona kadastrale 1503, Bashkia Tropojë, të pasurisë me nr. 886, zona kadastrale 1402, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 792, zona kadastrale 3509, Bashkia Dibër, të pasurive me nr. 36 dhe 66, zona kadastrale 2640, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 157/13, zona kadastrale 2302, Bashkia Shkodër, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, në qarqet Kukës, Dibër dhe Shkodër, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me nr. 61/6/6, zona kadastrale 1503, Bashkia Tropojë, të pasurisë me nr. 886, zona kadastrale 1402, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 792, zona kadastrale 3509, Bashkia Dibër, të pasurive me nr. 36 dhe 66, zona kadastrale 2640, Bashkia Dibër, të pasurisë me nr. 157/13, zona kadastrale 2302, Bashkia Shkodër.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Kukës, Këshilli i Qarkut Dibër, Këshilli i Qarkut Shkodër, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tropojë, Dibër dhe Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Nr. rendor	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. m ²	Vendndodhja	Bashkia	Pronësia	Lëshuar certifikata
1	61/6/6	1503	2500	Domjan	Tropojë	Valter Milushi	ZVRPP Tropojë
2	886	1402	1125	Çidhen	Dibër	Basri Cami	ZVRPP Dibër
3	792	3509	8560	Staravec	Dibër	Sali Vrenezi	ZVRPP Dibër
4	36	2640	640	Melan	Dibër	Shemsi Ngota	ZVRPP Dibër
5	66	2640	300	Melan	Dibër	Shemsi Ngota	ZVRPP Dibër
6	157/13	2302	10000	Shkodër	Shkodër	Ndriçim Gjoni	ZVRPP Shkodër